



Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Bashkangjituni!

One billion Rising

14 Shkurt. 17:00, afër Hotel Grand, Prishtinë

Protesta "Ne jemi me ju"

8 Mars, Sheshi i Skenderbeu, 12:00, Prishtinë

Në këtë numër

Fondi i Grave të Kosovës Shqyrton

Arritjet Kryesore.....2

Një anëtare individuale e RrGGK-së tregon për mbështetjen e familjes së saj për Rrjetin e Grave.....3

RrGGK vizitoi Kryesuesen e Asamblesë Komunale të Gjilanit.....3

Bent shfaqet në Teatrin e Prishtinës dhe "thyen tabutë".....3

RrGGK kontribon në Raportin EPLO mbi zbatimin e rezolutës 1325.....4

Anëtarët dhe bashkëpunëtorët vlerësojnë pozitivisht punën e RrGGK..4

Baronesha Catherine Ashton u Përgjigjet Aktivisteve.....4

 [Faqja në Facebook](#)

 [Lista e dërgesave të E-Buletinit](#)

Aktivistet Përgëzojnë Kryetaren e Parë Grua të një Komune

Një buqetë me lule i dhurua gruas së emëruar sipas një luleje: Mimoza Kusari – Lila. Ashtu siçulet sjellin pranverën, edhe zgjedhja e saj si kryetare e komunës, solli pranverë jo vetëm në zemrat e qytetarëve të Gjakovës, por edhe në zemrat e përkrahësve të barazisë gjinore, duke ri-shprehur besimin e tyre se gratë mund t'ia dalin e të përzgjedhen në pozita vendim-marrëse.

Një delegacion i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) i përbërë nga anëtare të Bordit dhe stafit të RrGGK, vizitoi gruan e parë kryetare të një komune në Kosovë, Znj. Mimoza Kusari – Lila në zyrën e saj në [Kuvendin Komunal të Gjakovës](#).

Fillimisht, ato i uruan znj. Kusari - Lila për fitoren në zgjedhjet e fundit lokale, duke thënë se "zgj. Kusari Lila tashmë është një kryetare "legendare", e cila ka thyer akullin, duke u bërë gruaja e parë kryetare e një komune në Kosovë.

Gjatë takimit u bisedua dhe u dhanë ide të ndryshme nga të dy palët lidhur me atë se si do të mund të ndikohet në fuqizimin ekonomik të grave në Komunën e Gjakovës; si mund të ndihmohej në ringjalljen e trupës teatrore profesionale të Gjakovës; si të ruhej trashëgimia kulturore e Gjakovës; për hapat që mund të ndërmerren në inkurajimin e pjesëmarrjes së grave që mirren me artizanate në panairin e artizanateve që mbahet çdo vit në Kosovë; për buxhetimin gjinor dhe përkrahjen e organizatave të grave në Komunën e Gjakovës.

Kryetarja e [Komunës së Gjakovës](#) shfaqti mirënjohjen e saj për punën e RrGGK-së, duke treguar gadishmëri bashkëpunimi në të ardhmen. "Do të jem në gjendje që të motivojë gratë e Komunës së Gjakovës për më shumë rol në vendimmarrje dhe përfshirje në sfera të ndryshme të jetës, sidomos në fushën e biznesit," tha Znj. Kusari – Lila.

Në këtë takim, RrGGK hapi edhe temën e shpalljes zyrtare të "Shtëpisë Muze" të familjes Qerkezi, me ç'rast përfaqësueset e RrGGK-së u ndjenë të lehtësuara kur vërejtën gadishmërinë dhe planin ekzistues të Znj. Kusari – Lila për të ndërmarrë hapa konkret në këtë drejtim.

"Përveç shpalljes muze, kjo shtëpi do të ketë edhe personin që do të bëjë mirëmbajtjen e shtëpisë dhe do të përkujdeset për guiden," tha Mimoza Kusari – Lila, Kryetare e Komunës së Gjakovës.

Pas përfundimit të takimit me Znj. Kusari – Lila, delegacioni i RrGGK-së takoi përfaqësueset e Shoqatës "Thirrjet e Nënave", takim ky që u mbajt në shtëpinë muze të familjes Qerkezi në Gjakovë. Përveç shprehjes së mirënjohjes së lartë për sakrificën e kësaj familjeje në luftën e fundit në Kosovë, u bisedua edhe për ndërmarrjen e një aksioni të përbashkët nga RrGGK dhe Shoqata "Thirrjet e Nënave".

Së bashku, të dy organizatat vendosën që më 8 Mars 2014, të ndërmarrin një aksion në rrugë, që sërish të ngrisin zërin për çështjen e personave të pagjetur në Kosovë. "Kjo ishte një ditë shumë e bukur dhe e frytshme," cilësoi njëra nga anëtarët e delegacionit të RrGGK-së. "Jam e lumtur që isha pjesë e këtij delegacioni."



RrGGK viziton kryetaren e re të Komunës së Gjakovës, Znj. Mimoza Kusari-Lila më 20 Janar.

Fondi i Grave të Kosovës Shqyrton Arritjet Kryesore

Pas një sërë konsultimesh me 100 organizatat anëtare, u krijua Fondi i Grave të Kosovës (FGK) me qëllim që të përkrahë nevojën primare duke mbështetur organizatat e grave ne kohën e zhvendosjes së prioriteteve të ndihmës në Kosovë.

RrGGK e krijoi këtë Fond me mbështetje bujare të Kvinna till Kvinna (KtK) dhe më vonë të Austrian Development Agency (ADA), për t'u dhënë grante të vogla organizatave të grave të cilat nuk kanë qasje në burime tjera të fondeve.

Përderisa RrGGK po kërkon fonde tjera dhe planifikon zgjerimin e vazhdueshëm të FGK-së, ne duam të reflektojmë dhe të ndajmë arritjet dhe sfidat tona që i kemi hasur deri tash me këtë Fond.

Që nga vjeshta e vitit 2012, RrGGK ka dhënë 34 grante, në total prej 66,671 Euro për organizatat anëtare të saj nëpërmjet FGK.

Prej këtyre iniciativave kanë **përfitur drejtpërdrejtë 2,039** gra duke përfshirë këtu gra me aftësi të kufizara, gra prej vendeve rurale, gra të etniciteteve të ndryshme (p.sh. Turke, Gorane, Serbe, Roma, Ashkalike, Egjiptiane dhe Shqiptare), vajza dhe pensionere.

Më tepër se 1,500 persona në komunitetet e tyre kanë përfitur indirekt nga këto projekte. Këto grante të vogla (deri në €3,000) kanë arritur të bëjnë ndryshime thelbësore në jetët e tyre.

Mes pesë qëllimeve strategjike të RrGGK-së si rrjet, shumica e iniciativave të mbështetura nga Fondi janë përqëndruar në ngritjen e kapaciteteve të anëtareve të RrGGK në shëndetësi dhe fuqizimin ekonomik të grave.

Përmes aktiviteteve gratë janë informuar për kancerin dhe po ashtu projektet iu kanë ndihmuar grave të marginalizuara të arrijnë të bëjnë të paktën një vizitë gjinekologjike te mjeku.

Përfituesit tjerë të granteve i kanë fuqizuar ekonomikisht gratë duke iu mësuar teknika të biznesit dhe duke ju mundësuar qasje në tregje të reja.

Sfida më e madhe për RrGGK-në dhe anëtarët e saj ka qenë procesi i të mësuarit se si të implementohen projektet, posaçërisht krijimi i sistemeve financiare dhe gjithë dokumenteve të tjera që kanë të bëjnë me implementimin e projektit.

Prandaj RrGGK vendosi të japë mbështetje për përfituesit e granteve edhe gjatë implementimit të projektit dhe shpesh edhe pas mbarimit të tij.

Kjo ka qenë tepër e rëndësishme pasi për shumicën e organizatave kjo ka qenë hera e parë që ato kanë menaxhuar një projekt.

Kjo ka përfshirë vizita në teren, ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin financiar, ndihmë me menaxhimin organizativ, këshilla për strategjitë efektive të avokimit, bashkëpunimit me zyrtarë qeveritar dhe zgjidhjen e problemeve.

Ne gjithashtu i kemi nxitur anëtarët tona të mendojnë në mënyre aktive për qëndrueshmërinë e cila nënkupton planifikimin e hershëm të iniciativave dhe të arrijnë të marrin mbështetje e cila do të mundësojë vazhdimin e këtyre iniciativave edhe pas mbarimit të këtyre projekteve të vogla.

Në vitin 2013, RrGGK ka mundësuar më tepër se 300 sesione mentoriale për anëtarët e saj përmes telefonit, e-mailit ose kontaktit personal.

Të arriturat kryesore të Fondit të Grave të Kosovës

- Më shumë se 2,811 gra dhe vajza kanë përfutur deri më sot
- Ngritja e kapacitetit të anëtareve të RrGGK-së për të shkruar propozime
- Anëtare të ndryshme të RrGGK-së, duke përfshirë grupet rurale dhe minoritare, kanë qasje në fonde
- Zyrtarët Komunal për Barazi Gjinore dhe institucione të tjera janë përfshirë në nismat e anëtareve të RrGGK-së
- Anëtarët e RrGGK-së kanë fituar shkathtësi në avokim duke përdorur metodën “mësimi përmes praktikës”
- Anëtarët e RrGGK-së kanë siguruar bashkë-financim substancial për nismat e tyre
- Anëtarët e RrGGK-së dhe përfitueset kanë ndërmarrë nisma shtesë në baza vullentare pas përfundimit të projekteve fillestare
- Anëtarët e RrGGK-së janë të njohura për publikun përmes televizionit, mediave online, gazetave, uebfaqes së RrGGK-së dhe Facebook-it.
- Kërkesa të mëdha për vazhdimin e Fondit të Grave

Një anëtare individuale e RrGGK-së tregon për mbështetjen e familjes së saj për Rrjetin e Grave

A i keni gjetur sot 5 cent në rrugë? Është një vend për to. Mendojeni t'i ruani të gjithë monedhat tuaja shpesh në një kuti për të mbështetur RrGGK-në. Kështu vepron Itziar Mujika dhe familja e saj nga Basque Country. Përveç që janë [anëtar individual](#), ata kanë gjetur një mënyrë tjetër për të mbështetur RrGGK-në.

“Është një kuti e vogël ku ne fusim para, monedha zakonisht”, tha ajo. “Në këtë mënyrë ne kursejmë për gratë e Kosovës pak nga pak”. Familja e saj gjithashtu i inkurajon kolegët dhe fqinjët të veprojnë nejtë.

Ne kemi shumë dëshirë të kemi më shumë anëtar si Itzar!

Është shumë lehtë të jesh anëtarë i RrGGK-së. [Vizitoni](#) faqën tonë për më detajisht.

Si një anëtar i RrGGK-së, ju mund të ndiheni krenarë që jeni pjesë e një rrjeti mbarë botërorë të njerëzve të përkushtuar për të mbështetur, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë.

Si anëtar, ju do të pranoni informata të përditësuara për punën e RrGGK-së dhe atë se si i kemi shpenzuar fondet e anëtarëve për qëllime të mira. Kjo përfshinë E-Buletinën mujor dhe raportin vjetor me pasqyrat financiare të audituara.

P.S. Jo vetëm gratë kanë të drejtë me u bë anëtare individuale. Shumë burra përkrahin punën tonë.

RrGGK vizitoi Kryesuesen e Asamblesë Komunale të Gjilanit



Valentina Bunjaku-Rexhepi kryesuesja e parë grua në Asamblesën Komunale të Gjilanit

Valentina Bunjaku-Rexhepi, është zgjedhë Kryesuese e Asamblesë Komunale të Gjilanit, post të cilin deri më tani nuk e kishte udhëhequr asnjë grua në këtë komunë.

Përfaqësuese të RrGGK-së vizituan znj. Bunjaku-Rexhepi për t'i uruar asaj këtë post shumë të rëndësishëm për Komunen e Gjilanit.

“Më së shumti kam marrë vota prej grave dhe do angazhohem maksimalisht në implementimin e barazisë gjinore në komunën tonë” u tha ajo përfaqësueseve të RrGGK-së.

Tejet e zëshme në Asamble, por edhe jashtë saj, më shumë se kushdo tjetër ajo ka besuar në fitoren e subjektit të saj politik dhe ia kishte dalë që të jetë kandidatja më e votuar në Gjilan dhe njëra ndër femrat më të votuara në Kosovë.

E lindur në vitin 1978 në Gjilan, Valentina Bunjaku-Rexhepi, me profesion profesore dhe e angazhuar edhe jashtë politikës - është edhe kryetare e klubit të futbollit “Drita”, në konkurrencën e femrave.

Ajo ndjehet e nderuar që subjekti politik nga ajo vjen, e ka propozuar për të qenë kryesuese e Asamblesë, e edhe më krenare ngase ka marrë besimin e shumicës së këshilltarëve dhe jo vetëm nga subjekti i saj politik, por edhe nga subjektet tjera që përfaqësohen në Asamble.

Bent shfaqet në Teatrin e Prishtinës dhe “thyen tabutë”

E performuar pothuajse në të gjithë teatrot e botës, së fundi qytetarët e Kosovës patën rast të ndjekin shfaqjen Bent nga Marin Sherman, në teatrin e kryeqytetit. Shfaqja e drejtuar nga regjisori Andrej Nosov, trajton temën e homoseksualitetit në kampet naziste. Kjo shfaqje u luajt nga aktorët dhe aktivistët për të drejtat e njeriut: Alban Ukaj, Branko Cvejic, Radovan Vujovic, Boris Ler and Drasko Adzic. Shfaqja ngjalli shumë emocione.

Shfaqja e luajtur anembanë botës që tregon në lidhje me gjendjen e vështirë të homoseksualëve në kampet naziste të përqendrimit, ka terhequr vëmendjen e mediave në Kosovë. Shfaqja e performuar në Prishtinë më 21- 22 Janar, “ka thyer tabutë” sipas Koha.net.

Shikuesit mbushën Teatrin Oda në Prishtinë dhe ofruan ovacione të zgjatura pas secilës shfaqje të dramës.

“Kjo shfaqje ka një temë interesante dhe performacë të mirë,” komentoi Shpend Ahmeti, Kyretar i Prishtinës i cili ishte pjesë e audiencës. “Ajo flet për persekutimin e njerëzve për shkak të besimit të tyre, orientimit të tyre seksual. Në këtë mënyrë, shfaqja flet për të drejtat e njeriut, tema të cilat zakonisht në Kosovë janë tabu. Në këtë kontekst, arti mund të edukojë njerëzit,” shtoi ai.

Shfaqja u krijua në një bashkëpunim mes [Hartefakt](#) Fund me seli në Beograd dhe Qendrës për Barazi dhe Liri ([Center for Equality dhe Liberty – CEL](#)) në Prishtinë, i cili është një grup avokues për LGBT.

Pas shfaqjes CEL organizoi një diskutim për të pranishmit dhe gazetarët.

RrGGK kontribon në Raportin EPLO mbi zbatimin e rezolutës 1325

RrGGK ka kontribuar në një nismë më të gjerë kërkimore në monitorimin e zbatimit të Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325, për paqën dhe sigurinë e grave publikuar nga [Zyra Ndërlidhëse Evropiane për Ndërtimin e Paqës \(EPLO\)](#) në 2013.

Pas monitorimit që është bërë më heret për rezolutën *1325 Fakte dhe Fabula*, rasti studiomor i fundit nga RrGGK ka bërë të ditur që Kosova ka arritur “përparim të dukshëm” që nga viti 2010.

“Përderisa Kosova ende duhet ta miratoj Planin Kombëtar të Veprimit (PKV) (National Action Plan) në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) 1325, procesi i hartimit të një PKV ka përfshirë një Grup Punues ndër-sektorial me përfaqësues të institucioneve kryesore dhe shoqërisë civile. Implementimi i PKV në të ardhmen do të varet nga fakti nëse Grupi Punues është në gjendje të përcaktojë më qartë përgjegjësitë institucionale për aktivitetet, alokimin e buxhetit dhe monitorimin.”

Anëtarët dhe bashkëpunëtorët vlerësojnë pozitivisht punën e RrGGK-së

Edhe një vit u mbyll me takimin tradicional të anëtareve të RrGGK-së të mbajtur më 7 Dhjetor, ku anëtarët tona, përveç aktiviteteve të ndryshme të këtij takimi, bënë edhe vlerësimin e punës së RrGGK-së. Çdo vit anëtarët, parnterët dhe bashkëpunëtorët tjerë plotësojnë një pyetësor anonim për programet dhe shërbimet e rrjetit.

Responentët vlerësuan punën e rrjetit gjatë vitit 2013 shumë pozitivisht. Takimet dhe shërbimet e RrGGK i vlersuan “shumë të dobishme”. Responentët vlerësuan se ndër sukseset më të mëdha të RrGGK-së të jetë implementimi i strategjisë, aktivitetet për ngritjen e vetëdijes dhe Fondin e Grave të Kosovës. Ato poashtu cekën që me mbështjetjen e RrGGK-së kanë dorëzuar 121 projekt propozime donatorëve të ndryshëm vitin e kaluar.

“Ne jemi organizata të vogla dhe nuk kemi eksperiencë në shumë fusha”, shkruajti një anëtare. “Trajnimet e RrGGK-së na kanë ndihmuar shumë.”

“Duke aplikuar për grante në [Fondin e Grave të Kosovës](#), ne kemi mësuar si të shkruajmë projekt propozime. Ky është një gjë shumë e madhe për ne.” tha një tjetër anëtare.

Anëtarët mendojnë se FGK duhet të mbështet nga bizneset lokale dhe po ashtu të prezantohet në shtetët e tjera me qëllim që të sigurohen edhe fonde tjera.

Responentet po ashtu vlerësuan Buletinin elektronik *Zëri i Grave Kosovare*, ëebfaqen dhe faqën në Facebook “shumë të dobishme”.

Ndërsa ato thanë se stafi i RrGGK-së i ka ndihmuar shumë, ato do të dëshironin që stafi t'i vizitonte më shpesh, për këtë arsye stafi i RrGGK-së planifikon të organizojë më shumë vizita për anëtarët në vitin 2014

Baronesha Catherine Ashton u pergjigjet Aktivisteve

Organizatat për të drejtat e grave nga Kosova, Serbia dhe Suedia, përfshirë Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), [Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut](#), [Gratë në të Zeza \(Women in Black\)](#) dhe [Kvinna till Kvinna \(KtK\)](#) dërguan një letër Përfaqësueses së Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS), Baroneshës Catherine Ashton më 4 Dhjetor 2013. Në letër ato thanë që Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqën dhe Sigurinë nuk është zbatuar gjatë bisedimeve të fundit në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Baronesha Catherine Ashton u pergjigj më 21 Janar 2014. Ajo falenderoi aktivistet për interesimin e tyre për të kontribuar në procesin e normalizimit të raporteve në mes Beogradit dhe Prishtinës. “Unë do të kem kënaqësinë të ju takoj në vizitën time të ardhshme në Prishtinë dhe Beograd”, tha ajo. Klikoni [këtu](#) për të lexuar letrën e baroneshës Ashton.



Gjatë takimit vjetor të RrGGK-së anëtarët vlerësuan bunën e RrGGK gjatë vitit 2013.